

URDHËR
Nr. 590, datë 12.12.2022

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe në informacionin e përditësuar, të marrë nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE),

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
- b) zogjtë 24-orësh;
- c) shpendë dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezët e shpendëve;
- dh) mishi i shpendëve;
- e) nënproduktet e shpendëve.

Nga shteti i Hungarisë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Bács-Kiskun	Kiskunmajsa	
2.	Bács-Kiskun	Kiskőrös	
3.	Bács-Kiskun	Kiskunhalas	
4.	Bács-Kiskun	Kecskemét	
5.	Bács-Kiskun	Kiskunfélegyháza	
6.	Bács-Kiskun	Jánoshalma	
7.	Békés	Orosháza	
8.	Csongrád-Csanád	Mórahalom	
9.	Csongrád-Csanád	Kistelek	
10.	Csongrád-Csanád	Szentes	
11.	Csongrád-Csanád	Szeged	

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjtë 24-orësh, shpendë dekorativë, materialit biologjik, vezët e shpendëve, mishi i shpendëve dhe nënproduktet e shpendëve, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca